



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2024:083585

Datë: 04.06.2024

Numri i dokumentit: 05780382

P.nr.2024/083585

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – DEGA RAHOVEC/Departamenti përgjithshëm penal**, gjyqtari vetëm gjykues Mizahir Shabani, me sekretaren juridike Shemsije Shehu, në lëndën penale kundër të akuzuarit A.K nga fshati Nagavc, Komuna e Rahovecit, për shkak të veprës penale, mbajtje në pronësi kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 366/1 të KPRK-se, i akuzuar sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Gjakovë-Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr. 289/2024 të datës 22.03.2024, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit fillestare, të mbajtur më dt. 04.06.2024, në prezencën e përfaqësuesit të Prokurorisë Themelore në Gjakovë, prokurorit të shtetit Qazim Kuqi, të akuzuarit A.K dhe mbrojtësit të tij avokati M.M nga Rahoveci, i caktuar sipas autorizimit, me datën 04.06.2024, mori dhe shpalli këtë :

## A K T G J Y K I M

**I akuzuari: A.K** nga fshati Nagavc, Komuna e Rahovecit, ku dhe jeton, nga i ati M dhe e ëma H e lindura H, i lindur me datën ....., ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, i ati i një (1) fëmiu, i gjendjes së mesme ekonomike, më parë i pa dënuar, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

## ËSHTË FAJTOR

Në kohë të panjohur e gjerë me datën 28.02.2024, rreth orës 21,50 minuta në fshatin Krushë e Madhe, Komuna e Rahovecit, konkretisht në veturën që po e drejtonte, në kundërshtim me nenin 5/1 të Ligjit për Armë mban në pronësi dhe kontroll armë, në atë mënyrë që i pandehuri pa autorizim mban në posedim municion si: 20 fishek të llojit kalibrit 7.62 mm, 39 fishek të kalibrit 9 mm, të armës me gaz, si dhe një thikë me gjatësi 17 cm, të cilat i posedon deri me datën 28.02.2024, kur edhe i gjenden në veturën e tij nga Policia e Kosovës.

**me çka ka kryer veprën penale, Mbajtje ne pronësi, kontroll ose posedim te pa autorizuar te armëve nga neni 366/1 te KPRK-se,**

Andaj Gjykata me aplikimin e neneve 4, 6, 7, 17, 38, 39, 43, 69, 70, nenit 366 par. 1 te KPRK- dhe nenit 364 të KPPK-së, të akuzuarin e,

### **G J Y K O N:**

Me dënim me gjobë në lartësi prej **600,00 ( gjashtë qind) €**, te cilin dënim duhet ta paguaj ne afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit,

Në rast të mospagimit të dënimit me gjobë, i njëjti do të shndërrohet në dënim burgimi në kohëzgjatje prej 30 ( tridhjetë) ditëve duke llogaritur çdo ditë burgimi me nga 20. €.

Te akuzuarit konform neni 366/3 të KPRK-së, i shqiptohet dënimi plotësues i konfiskohen : 20 fishekë 7.62 mm, dhe 39 fishekë me gaz kalibër 9 mm, dhe një (1) thikë 17 cm, me këllëf.

Detyrohet i akuzuari, që ti paguajë shpenzimet në emër të paushallit gjyqësor shumë prej tridhjetë (30) Euro si dhe në emër të kompensimit për viktimat e krimit shumë prej tridhjetë (30) Euro, të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore ne Gjakovë,-Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën PP/II. nr. 289/2024 të datës 22.03.2024, kundër të akuzuarit A.K nga fshati Nagavc, Komuna e Rahovecit, për shkak të veprës penale Mbajtje në pronësi, në kontrollë posedim, ose shfrytëzim të paautorizuar të armeve nga neni 366 par.1 te KPRK-se, me propozim për caktimin e seancës për aprovimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë.

Gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit fillestare, ku prezent ka qenë përfaqësuesi i akuzës Prokurori i Shtetit Qazim Kuqi, i akuzuari A.K, si dhe mbrojtësit i tij avokati M.B, sipas autorizimit.

Gjykata gjatë seancës dëgjimore të shqyrtimit te marrëveshjes për pranimin e fajësisë ka dëgjuar të akuzuarin, mbrojtësin e tij, si dhe përfaqësuesin e Prokurorisë Themelore ne Gjakove, - Departamenti i Përgjithshëm, Prokurori i Shtetit Qazim Kuqi.

Prokurori i Shtetit ka deklaruar se në tërësi ngel pranë marrëveshjes me nr. PP/II.nr. 289/2024 të datës 22.03.2024, e lidhur në mes te Prokurorit, të akuzuarit dhe mbrojtësit te tij, për të cilën lidhur me kushtet dhe llojin e dënimit është e njoftuar Gjykata si dhe vet i akuzuari. Andaj përveç kushteve të caktuar në këtë marrëveshje ne si Prokurori, nuk kemi çka të shtojmë dhe i propozojmë Gjykatës që kjo marrëveshje të aprovohet dhe të jetë pjesë përbërës ne shkresat e lëndës. Njëherit i propozon gjykatës që të akuzuarit ti shqiptohet dënimi plotësues ti konfiskohen armët siqë janë në dispozitiv të akuzës konform dispozitave të nenit 366/3 të KPRK-së.

Mbrojtësit i të akuzuarit A.K, av.M.B, ka deklaruar se: e mbështesim në tersi marrëveshjen e arritur mbi pranimin e fajësisë në Prokurorin Themelore në Gjakovë me datën 22.03.2024, duke i propozuar gjykatës që ta aprovoj në tersi marrëveshjen e arritur mbi pranimin e fajësisë. Ka deklaruar se heqin dorë nga e drejta për ushtrimin e ankesës kundër aktgjykimit të gjykatës që do ta bjen dhe i ka propozuar gjykatës që i njëjti të jetë i plotfuqishëm nga dita e marrjes së aktgjykimit.

Gjykata pas dëgjimit te pretendimeve te Prokurorit te akuzuarit mbrojtësit të tij, lidhur me marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë ka konstatuar se i akuzuari A.K, ka kuptuar natyrën dhe pasojat të pranimit të fajësisë, ky pranim është bërë në baza vullnetare pas konsultimeve të nevojshëm me mbrojtësin e tij, i akuzuari nuk ka qene i detyruar ose i shtrënguar ne asnjë mënyrë që të pranoi fajësinë, pranimi i fajësisë mbështet në fakte dhe prova të cilat janë paraqitur ne aktakuzë, dhe janë pranuar dhe nga vete i akuzuari. Po ashtu Gjykata ka vërtetuar se nuk ekziston asnjë nga rrethanat për hudhjen e aktakuzës, apo të pushimit te procedurës penale të parapara me nenin 248 te KPPK-se.

Gjykata gjendjen faktike të përshkruar ne dispozitiv te këtij aktgjykimi e ka vërtetuar jo vetëm nga pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit por edhe nga provat qe gjenden ne shkresat e lëndës, e për të cilat provat mbrojtja nuk ka pasur kundërshtime, siç janë: raporti i policit V.M ID ... të datës 28.02.2024, Raporti fillestar i incidentit të datës 28.02.2024, Lista mbi armët e konfiskura të datës 28.02.2024, dhe deklarata e të pandehurit A.K e dhënë në Polici me datën 28.02.2024 dhe në Prokurorin Themelore në Gjakovë me datën 22.03.2024.

Andaj, Gjykata ka ardhur ne përfundim se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha elemente qenësore të përshkruar si në dispozitiv te këtij aktgjykimi, dhe për këtë ka vendosur që të pranoi fajësinë e të akuzuarit dhe të akuzuarin të shpalli fajtore dhe të dënoi në bazë te Ligjit.

Gjate seancës për caktimin e dënimit Prokurori i çështjes ka deklaruar se: mbetet pranë dënimit të rekomanduar në marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë të paraparë në faqen e parë të marrëveshjes, ku është propozuar që dënimi me gjobë të jetë nga 500 €, gjere ne 700 €.

Mbrojtësi i të akuzuarit A.K, avokati M.B nga Rahoveci ka deklaruar se e përkrah dënimin e përcaktuar në marrëveshje mbi pranimin e fajësisë.

I akuzuari A.K, ka deklaruar se: e mbështet fjalën e mbrojtësit te tij, dhe pendohet për veprën e kryer dhe shpreh keqardhje.

Gjykata duke vendosur mbi sanksionin penale juridike te propozuar ne marrëveshje ka vlerësuar te gjitha rrethanat komform nenit 69 dhe nënti 70 te KPRK-se, qe ndikojnë ne llojin dhe lartësinë e dënimit, ashtu që si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin gjeti se pranimin e fajësisë nga ana e tij, në të gjitha fazat e procedurës penale, pendimin e tij, për veprën e kryer qëndrimin e tij korrekte gjatë gjykimit, jo dënueshmerinë e tij, andaj të njëjtit i ka shqiptuar dënimin me kuadër të marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë duke shqiptuar dënim me gjobë në shumë prej 600 €, me shpresë dhe bindje se dënimi i shqiptuar do të arrijë qëllimin e dënimit i parapare me dispozitat e nenit 38 te KPRK-së .

Vendimi mbi konfiskimin armës është ne pajtim me nenin 366 par. 3 të KPRK-se.

Vendimi mbi shpenzimet e paushallit gjyqësor bazohet në nenin 452 par.1 të KPPK-së, ndërsa vendimi për kompensimin e viktimave të krimit u mor në kuptim të nenit 36 paragrafi 3 nënparagrafi 3.1 të Ligjit Nr.08/L – 109, për kompensimin e viktimave të krimit.

Nga sa u tha më lartë e në vështrim të nenit 364 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NE GJAKOVË, - DEGA NË RAHOVEC,  
-Departamenti i Përgjithshëm- divizioni Penal-  
P.nr. 2024/083585 me datën 04.06.2024**

**Sekr. juridike  
Shemsije Shehu**

**Gjyqtari i vetëm gjykues  
Mizahir Shabani**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë, nëpër mjet kësaj Gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë ne afati prej 30 ditëve, nga dita e pranimit të aktgjykimit.